



Prishtinë, 28 shkurt 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1116_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084),
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja,
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_891_2017 të datës 27 shkurt 2017 për shoqërinë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_891_2017 të datës 27 shkurt 2017 për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit, të datës 07.02.2019 nr. prot. 099/19 të shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., me adresë: rruga "Jonit", r. 92/2, Prizren, Republika e Kosovës, dhe

në seancën e mbajtur me datë 28 shkurt 2019 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_891_2017 të datës 27 shkurt 2017 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me **27 shkurt 2020 për ndërtimin e Hidrocentralit.**

A r s y e t i m

- o ZRRE me datë 21.12.2015 nga shoqëria NPN "Renelual Tahiri" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- o Bordi i ZRRE-së, pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 23 shkurt 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar Nr. V_789_2016 dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.




- ZRRE me datë 10.02.2017 nga shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i ZRRE me datë 27 shkurt 2017 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V_891_2017 shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë, 07.02.2019 nga shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimin për Autorizimin FINAL V_891_2017 të datës 27 shkurt 2017, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, **edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 27 shkurt 2020 për finalizimin e projektit.**
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: janë në fazën përfundimtare të investimit të projektit HC Orqusha. Vepra e marrjes, Dekantuesi, Tubacioni dhe shtëpia e Centralit (Objekti i Makinerisë) janë ndërtuar dhe të përfunduara, pra në aspektin fizik projekti është i finalizuar.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., poashtu ka sqaruar se kanë përfunduar punët brenda objektit të makinerisë, vendosja e gypit të bifurkacionit, vendosja e dy turbinave, dy tubave të shkarkimit, dy valvulave kryesore, dy gjeneratorëve, sistemi i tokëzimit, si dhe sistemi hidraulik për secilën turbinë janë pozicionuar dhe montuar sipas projektit dhe këto punime tani më janë përfunduar.
- Gjithashtu kanë sqaruar se pjesa elektrike si transformatorët, shpërndarësit e tensionit të mesëm, dhe dhoma e kontrollit me scada sistemin janë montuar në pozicionet e tyre sipas projektit, shtrirja e kabllave të tensionit dhe sinjalistika kanë përfunduar dhe janë testuar në bazë të standardit të matjes “EN 8001”, dhe të gjitha janë kaluar me sukses.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka sqaruar se shtirja e largpërçuesit pothuajse ka përfunduar ku janë shtrirë kabllot e largpërçuesit për tetë (8) km gjatësi, pusetat janë përfunduar dhe të ndërtuara sipas specifikacioneve të kërkuar nga KEDS SH.A., dhe vonesat janë shkaktuar nga mungesa e ofrimit të kushteve të kyçjes në nënstacionin TS 35/10 kV Dragash, ku tash më janë tejkaluar këto probleme dhe ky projekt pritet të lëshohet shumë shpejt në fazën testuese dhe hyrjen në operim.



- Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që t’iu lejojehet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_891_2017 të datës 27 shkurt 2017, për finalizimin e këtij hidrocentrali edhe për një afat kohorë një (1) vjeçar.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Orqusha, ZK Orqushë, me kapacitet të instaluar prej 4 MW, komuna e Dragashit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejojehet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_891_2017 i datës 27 shkurt 2017, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_891_2017 i datës 27 shkurt 2017, do të vlen deri me datë **27 shkurt 2020**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, dhe në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së dhe
- Arkivit të ZRRE-së